

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kërcënimet ruse/ Von der Leyen kërkon krijimin e Këshillit të Sigurisë Evropiane
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/16/kercenimet-ruse-von-der-leyen-kerkon-krijimin-e-keshillit-te-sigurise-evropiane/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 11:46:07 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 11:44:38 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b2157835a9314512b65ee4135fdde5a65e37cfb5b586ec60c85f3378fc382784
TEKSTI	3eef2fd5d1daf7c6c75e619d8ca6093e9d3c5ed5f1c84e24e137ddf39b5e3ba5
PAMJA	87927e9dc445776ca8d999aa9846cb295f543da1bf76b5d996d4355d3f3c70ae

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	875a91cf9584114319fe51dae373698bebdde641732cf5fec0e890b2d30fc4a7
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	aa4643f280403755043cdd17fa8b750c8d4cc9789c755656633151c3e6ad021e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/875a91cf9584114319fe51dae373698bebdde641732cf5fec0e890b2d30fc4a7>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > AKTUALITET

Kërcënimet ruse/ Von der Leyen kërkon krijimin e Këshillit të Sigurisë Evropiane

13:44 : 16/09/2026 në AKTUALITET



Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, deklaroi se “kërcënimet” që vijnë nga Rusia janë “në rritje” dhe se, sipas saj, “janë gjithnjë e më pak hibride”, prandaj ajo kërkoj krijimin e “Këshillit Evropian të Sigurisë”.

“Lufta e agresionit e Rusisë kundër Ukrainës po shpërthen dhe kërcënimet në tokën tonë po intensifikohen. Duhet të jemi të qartë se ky ishte një sulm duke përdorur materiale ushtarake nga operativët rusë në tokën evropiane dhe një sulm jo vetëm ndaj një shteti anëtar, por ndaj të gjithë Unionit tonë”, tha Von der Leyen në një fjalim para Parlamentit Evropian në Strasburg, ndërsa foli për incidentet që përfshinin dronë javën e kaluar në Lituani dhe Danimarkë, si dhe në Poloni, ku Rusia bombardoi një tren pasagjerësh pikërisht në kufirin me Ukrainën.

Ajo tha se “kërcënimet hibride me të cilat po përballet Evropa janë gjithnjë e më pak hibride, dhe gjithnjë e më pak kërcënime”. *“Sabotim kibernetik, zjarrvënie. Ndërhyrje nga dronë. Ato po shtohen çdo ditë”,* theksoi Von der Leyen.

Ajo shtoi se është e nevojshme të rritet gatishmëria e Bashkimit Evropian, si dhe se sistemet ekzistuese janë “të krijuara për një botë tjetër”.

Lexo edhe:[FBI zbulon planin rus për vrasje në SHBA dhe Europë](#)[Rrezik lufte në lindje të Evropës! Fregata ruse lëshon dy raketa ndaj helikopterit danez](#)

Von der Leyen tha se BE-së i duhej “manuali i vet për të kundërshtuar masat hibride”, në mënyrë që të mund t'i përgjigjej incidenteve pak nën pragun e agresionit të armatosur.

Duke folur për Nenin 4 të NATO-s në BE, pra “protokollin mbi sigurinë emergjente”, Von der Leyen tha se “kur një shtet anëtar e inicion atë, të gjitha shtetet anëtare duhet të takohen për të koordinuar një përgjigje evropiane për të parandaluar përshkallëzimin e mëtejshëm dhe për të zbutur pasojat”, dhe ajo bëri thirrje për krijimin e një “Këshilli Evropian të Sigurisë”.

Von der Leyen, në një fjalim në gjermanisht, tha se BE do t'i ofrojë mbështetjen më të fortë

TË GJITHA

Kërcënimet ruse/ Von der Leyen kërkon krijimin e Këshillit të Sigurisë Evropiane

13:44 : 16/09/2026



Haxhiu pas aktgjykimit në Hagë: Fjala e fundit juridike nuk është thënë

13:39 : 16/09/2026



Nga Guardian te Reuters, çfarë shkruajnë mediat e huaja për vendimin e Gjykatës së Hagës për liderët e UÇK-së

13:28 : 16/09/2026



“Serbia vrau mbi 13 mijë persona”, Osmani: UÇK ishte betimi i përgjakur i njerëzve të shtypur që donin çlirimin

13:10 : 16/09/2026



Avokati i Thaçi: Godita kokën me grushte kur gjykatësi tha ‘Në emër të popullit të Kosovës’!

13:06 : 16/09/2026



Gjyqi në Hagë/ LDK thirrje partive: Të bëhemi bashkë! Momenti i vështirë për Kosovën

13:02 : 16/09/2026



Vendimi për liderët e UÇK-së, reagon politika shqiptare/ Rama: Marre! Bardhi: Ditë e rëndë për kombin shqiptar

13:01 : 16/09/2026

Ukrainës gjatë dimrit më të vështirë të luftës. “Detyra jonë mbetet ta mbështesim Ukrainën sa më shumë që të mundemi”, tha Von der Leyen.

Etiketa: Evrope Rusi Von der Leyen

Lajme të lidhura



FBI zbulon planin rus për vrasje në SHBA dhe Europë

09:58 : 16/09/2026



Rrezik lufte në lindje të Evropës! Fregata ruse lëshon dy raketa ndaj helikopterit danez

12:26 : 15/09/2026



Presidentja e Bankës Qendrore Evropiane: Evropa rrezikon të mbetet peng i SHBA-së dhe Kinës për AI

09:28 : 15/09/2026



Sinjal për Rusinë? Gjermania çon deri në 1,000 ushtarë në Lituani

16:46 : 14/09/2026



35.959 fluturime në ditë, Evropa regjistroi trafik ajror rekord gjatë verës

10:32 : 14/09/2026



Atentati ndaj aeroportit gjerman/ Gjurmët që çojnë drejt shërbimit sekret rus

11:28 : 13/09/2026



RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.

Na kontakto:

NA NDIQ



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.